FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

GLUKONAT KALCIUMI

Tretësirë për injeksion – 1000 mg / 10 ml
(Kalcium glukonat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Glukonat kalciumi dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Glukonat kalciumi
3. Si ta merrni Glukonat kalciumi
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Glukonat kalciumi
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË GLUKONAT KALCIUMI DHE PËRSE PËRDORET

Kalciumi është një element mineral i domosdoshëm për ruajtjen e barazpeshës elektrolitike dhe për funksionimin e duhur të shumë mekanizmave rregullatore.
Pamjaftueshmëria e kalciumit shoqërohet me çrregullime neuromuskulore dhe demineralizimin e kockave. Kalciumi e rrit efektshmërinë e leukociteve, shton fagocitozën dhe ka një efekt antieksudativ në kapilarët gjatë të ftohtit. Marrja e kalciumit e rrit përqëndrimin e tij në serum dhe në të gjithë organizmin. Nëntëdhjetëenëntë përqind (99%) e kalciumit në organizëm është e lidhur me fosfatet në kockat, kryesisht si hidroksiapatit.
Glukonat kalciumi indikohet në mjekimin e gjendjeve hipokalcemike dhe si mjekim shtesë në gjendjet alergjike. Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Glukonat kalciumi për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI GLUKONAT KALCIUMI

Mos merrni Glukonat kalciumi në qoftë se:
- keni mbindjeshmëri ndaj glukonatit të kalciumit ose ndaj lëndëve ndihmëse të tretësirës për injeksion;
- jeni me hiperkalçemi (p.sh. në hiperparatiroidizëm, mbidozim të vitaminës D, tumore që shkaktojnë dekalçifikim, p.sh: plazmocitoma, metastazat e kockave);
- vuani nga hiperkalçiuria e rëndë;
- vuani nga pamjaftueshmëria e rëndë e funksionit të veshkave;
- vuani nga sëmundje të veshkave dhe keni nevojë për trajtim të përsëritur ose të zgjatur me Glukonat kalciumi;
- vuani nga sindroma Zollinger-Ellison;
- vuani nga fibrilacioni ventrikular;
- jeni nën 18 vjeç dhe keni nevojë për trajtim të përsëritur ose të zgjatur me Glukonat kalciumi.

Kundërindikohet përdorimi i njëkohshëm i glukonatit të kalciumit me ceftriakson tek të porsalindurit (më pak se 28 ditësh), edhe në rastet kur përdoren në linja infuzioni të ndara.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos e përdorni tretësirën për injeksion, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Glukonat kalciumi
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:
- jeni duke u mjekuar me glikozide kardiotonike sepse në këto raste përqëndrimi i kalciumit në serum duhet mbikqyrur rregullisht;
- keni hiperkalçiuri të lehtë (që nuk i kalon 300 mg ose 7.5 mmol në 24 orë);
- keni dëmtim mesatarisht të rëndë të funksionit të veshkave ose me të dhëna të mëparshme për nefrolitiazë (gur në veshka) sepse duhet mbikqyrur sasia e kalciumit që jashtëqitet në urinë (në rast nevoje doza e kalciumit duhet ulur ose duhet ndërprerë; të sëmurët që kanë prirje për nefrolitiazë duhet të marrin sasi të konsiderueshme lëngjesh);
- vuani nga sëmundje kardiake;
- gjatë mjekimit me kalcium po merrni vitaminë D, duhet të ulet doza e saj, përveç rasteve kur ajo indikohet në mënyrë specifike;
- jeni i moshuar;
- merrni adrenalinë (epinefrinë).

Duhet të evitohet përdorimi i njëkohshëm i glukonatit të kalciumit me ceftriakson, duke qenë se mund të shfaqet formimi i precipitatit ceftriakson-kalcium.
Tretësirat e kripërave të kalciumit janë irrituese, ndaj duhet bërë shumë kujdes për të shmangur daljen jashtë vene të tretësirës gjatë administrimit intravenoz. Gjithashtu, kujdes duhet treguar tek pacientët me sarkoidozë dhe me disa sëmundje malinje.
Ky bar duhet të merret me kujdes në pacientët të cilët janë duke ndjekur një dietë të kontrolluar me kripëra.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë të tilla si:
- verapamil (kur përdoret në disa doza të larta bashkë me vitaminën D, kalciumi mund ta ulë përgjigjen e verapamilit dhe ndoshta edhe të kalcibllokuesve të tjerë);
- glikozide kardiotonike (përdorimi i sasive të mëdha të kalciumit mund ta shtojë rrezikun e aritmive kardiake);
- citrate (në të sëmurët që bëjnë transfuzion gjaku, citrati mund të shkaktojë një kalcemi më të lartë se norma; në të sëmurë të tillë, pjesa më e madhe e kalciumit e lidhur me citratin është jovepruese);
- diuretikë tiazidikë (përdorimi në të njëjtën kohë i diuretikëve tiazidikë mund ta rrisë ripërthithjen renale të kalciumit);
- ceftriakson (shiko pikën 2);
- adrenalinë (epinefrinë) (pakësohen efektet e adrenalinës pas kirurgjisë në zemër);
- magnez (kalciumi dhe magnezi frenojnë efektet e njëri – tjetrit në mënyrë reciproke).

Këto barna mund të ndikohen nga Glukonat kalciumi ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron, ndaj në përdorimin e njëkohshëm të tyre mund të nevojitet të ulet ose të rritet sasia e Glukonat kalciumi. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë, po planifikoni të mbeteni shtatzënë apo ushqeni fëmijën me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna që të tregojnë se glukonati i kalciumit ndikon në aftësitë për të drejtuar automjetin apo përdorur makineri.

3. SI TA MERRNI GLUKONAT KALCIUMI

Gjithmonë merreni këtë bar vetëm sipas kështillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Glukonat kalciumi janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Tretësira për injeksion Glukonat kalciumi përdoret si më poshtë:
Me injektim në venë
Të rriturit: 1 – 2 g (10 – 20 ml tretësirë për injeksion 1000 mg / 10 ml) në ditë.
Fëmijët deri në 1 vjeç: 100 – 200 mg (1 – 2 ml tretësirë për injeksion 1000 mg / 10 ml) në ditë;
1 – 6 vjeç: 200 – 250 mg në ditë;
6 – 15 vjeç: 250 – 500 mg në ditë.
Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Glukonat kalciumi për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për sa kohë duhet ta merrni.

Në qoftë se keni marrë më shumë Glukonat kalciumi
Në qoftë se keni marrë më shumë Glukonat kalciumi se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Glukonat kalciumi
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Përdorimi i kripërave të kalciumit në rrugë parenterale është shoqëruar me kalçifikim të indeve të buta.
Injektimi shumë i shpejtë intravenoz i kripërave të kalçiumit mund të çojë gjithashtu në hiperkalçemi, shije shkumësi në gojë, afshe të nxehta dhe vazodilatacion periferik.
Efekte të tjera që mund të shfaqen janë: djersitje, të përziera ose të vjella, hipotension, kolaps i qarkullimit, çrregullime të ritmit të zemrës (aritmi).
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI GLUKONAT KALCIUMI

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Glukonat kalciumi pas datës së skadimit, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban tretësira për injeksion Glukonat kalciumi
Lënda aktive është kalcium glukonat.
Çdo ampulë 10 ml përmban 1000 mg kalcium glukonat (10%).
Lëndët ndihmëse janë: acid borik, hidroksid natriumi, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 ampula.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.